



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



**PROJEKTI FITUES ME TITULL:**

**“ZHVILLIMI I INFRASTRUKTURËS  
NË SHËRBBIM TË FUQIZIMIT TË KËRKUESËVE TË RINJ  
DHE TË STUDENTËVE”**

**FINANCUAR NGA MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT  
NË KUADËR TË NDËRKOMBËTARIZIMIT TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT  
PËR VITIN AKADEMIK 2022-2023**



## **EKIPI I PROJEKTIT:**

Prof. Dr. Esmeralda KROMIDHA (koordinatore)

Prof. Asoc. Dr. Anida KISI


Prof. Asoc. Dr. Ogerta KORUTI

Prof. Asoc. Dr. Etleva KONDI

Dr. Elvana SHTËPANI

## **PERIUDHA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT:**

Shtator 2022 – Shtator 2023



# PËRSHKRIM I PROJEKTIT

Për të rritur cilësinë e kërkimit shkencor dhe për të qenë më konkurrues në treg, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, i Universitetit të Tiranës ka nevojë për mjedise bashkëkohore sikundër janë laboratorët shkencorë për realizimin jo vetëm të kërkimit shkencor por edhe për procesin e mësimdhënies në tërësi.



Laboratorët kërkimor shkencor janë një pjesë e qënësishme e sistemit arsimor, duke qenë se funksionet që ata kryejnë dhe mundësitë që ofrojnë si për stafin akademik ashtu edhe studentët janë të shumëllojshme, krahasuar me ata të përdorura në klasat tradicionale. Laboratorët shërbejnë si mjedise ku jo vetëm mësohet dhe praktikohet gjuha e huaj por edhe realizohet punë kërkimore dhe në veçanti eksperimente apo vëzhgime për qasjet e reja gjuhësore, për njohje me teknologji të reja në mësimdhënie, shkrime artikujsh apo teza doktoratash.

# Ngritja e infrastrukturës kërkimore-shkencore

Laboratorët kërkimor shkencorë bëjnë të mundur kryerjen e hulumtimeve në mënyrë më efikase dhe ofrojnë mundësi të reja për të zhvilluar qasje të reja metodologjike, mundësi bashkëpunimi dhe zhvillimi në disiplinat ekzistuese dhe ato të reja. Për më tepër, ata ofrojnë mundësi për përcimin e të dhënave dhe rezultateve kërkimore duke përdorur mënyra të reja. Këto mjedise do të mund të shërbejnë si mjet për të bërë ndryshime thelbësore në procesin, përmbajtjen dhe format e mësimdhënies duke bërë që të arrihen më mirë dhe më me efikasitet qëllimet e arsimit dhe kërkimit: *cilësi, integritet dhe arsimim për të gjithë.*



# QËLLIMI

Projekti synon të ngrejë hapësira të dedikuara për kërkimin shkencor dhe procesin e mësimdhënies/mësimnxënies, që do t'u ofrohen studentëve të të tre cikleve të studimit, kërkuesve shkencorë të UT-së si dhe studentëve apo kërkuesve shkencorë të cilët bëhen pjesë e UT-së nëpërmjet programeve të shkëmbimit:

- një sallë për realizimin e takimeve, tryezave apo konferencave shkencore;
- një sallë me pajisje audio dhe video për realizim e orëve mësimore;
- një sallë për studentët e doktoratës do të mund të punojnë për temën e tyre duke realizuar vëzhgime dhe intervista që do t'u shërbejnë gjatë përgatitjes së në punimin e doktoratës.

Gjithashtu këto ambjente do të përdoren për trajnime të vazhduara për mësuesit, përkthyesit, ndërmjetësve kulturorë dhe stafit të UT-së që dëshirojnë të përditësojnë dijet e tyre në fushat përkatëse.

# OBJEKTIVAT

- të krijojë tri hapësira të digjitalizuar për kërkuesit shkencorë;
- të ofrojë teknologjinë më të fundit në shërbim të palëve të interesuara;
- të sjellë një hov të ri në procesin e mësimdhënies dhe nxënies nëpërmjet përdorimit të teknologjive të reja;
- të ofrojë shërbime për të gjithë Fakultetet e UT dhe jo vetëm;
- të jetë në shërbim të stafit dhe studentëve të huaj që vijnë nëpërmjet programeve të ndryshme të shkëmbimit;
- t'u japë mundësi kërkuesve të rinj shkencor të hulumtojnë për të dhëna shkencore e t'i ndajnë ato me kolegët e tyre, të shkëmbejnë ekspertizë e të motivohen për kërkime të reja me natyrë shkencore inovative.